



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 185, Datë 29.05.2023

MBI

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 188 DATË 10.11.2017,
“PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË ALBGAZ SH.A. NË AKTIVITETIN E
TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 80 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.05.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 72/3 prot., datë 25.05.2023, të Drejtorive Teknike të ERE-s, “Për licencimin e shoqërisë ALBGAZ sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror”, i ndryshuar dhe një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 188 datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë ALBGAZ sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror”, i ndryshuar”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 353, datë 28.12.2022, vendosi të ndryshojë pikën 1 të vendimit nr. 188, datë 10.11.2017, i ndryshuar, si më poshtë:
 1. “Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. në veprimtarinë e transmetimit të gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 30.04.2023, të depozitojë në ERE Certifikatën e Sigurimit.”
- ERE njoftoi shoqërinë “ALBGAZ” sh.a. për vendimin e sipërcituar nëpërmjet shkresës nr. 72 prot., datë 11.01.2023 dhe me shkresën nr. 72/1 prot., datë 24.03.2023 i kujtoi shoqërisë detyrimin për të depozituar në ERE brenda afatit dokumentacionin e kërkuar.

- Shoqëria “ALBGAZ” sh.a. brenda afatit të përcaktuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 353/2022, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 72/2 prot., datë 25.04.2023, informoi ERE-n se në shkresën nr. 138 prot., datë 19.01.2023 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve lidhur me zbatimin e rregullave për periudhën kohore 13 Janar 2023 deri më 14 Maj 2023, nga të gjitha institucionet publike dhe entet e tjera ku shteti zotëron kapital/kuota/aksione ose dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, është përcaktuar ndër të tjera se *“Ndalohet promovimi i projekteve të ndryshme në investime për të cilat fondet janë planifikuar pas datës 13 janar 2023 dhe jashtë programit vjetor buxhetor të miratuar në fillim të vitit”*.
- Shoqëria “ALBGAZ” sh.a. ka miratuar buxhetin vjetor me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 1 datë 01.02.2023 dhe shpenzimi përkatës për Certifikatën e Sigurimit është i parashikuar në buxhetin e miratuar me këtë vendim. Në këto kushte, shoqëria “ALBGAZ” sh.a., duke qenë se e ka miratuar buxhetin e saj pas datës 13 Janar 2023, mbetet në pritje për kryerjen e shpenzimeve për Certifikatën e Sigurisë deri në përfundimin e zgjedhjeve vendore të datës 14.05.2023 dhe më pas do të vijojë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme.
- Për sa më sipër, shoqëria “ALBGAZ” sh.a. ka kërkuar shtyrjen deri më datë 30.08.2023 të afatit për depozitimin e Certifikatës së Sigurimit për aktivitetin e Transmetimit dhe Shpërndarjes së Gazit Natyror.
- Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 44.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se: *“Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.”*
- Duke marrë në konsideratë argumentet e shoqërisë dhe faktin që kjo vonesë ka qenë përtej vullnetit të saj si dhe kohën që i nevojitet për të miratuar buxhetin përkatës në Asamblenë e Përgjithshme dhe ndjekjen e procedurës për përzgjedhjen e ofruesit të këtij shërbimi dhe nënshkrimin e certifikatës përkatëse, vlerësohet të pranohet kërkesa e shoqërisë për zgjatjen e afatit të depozitimit të saj deri më datë 30.08.2023.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të ndryshojë pikën 1 të vendimit nr. 188, datë 10.11.2017, i ndryshuar, si më poshtë:

1. *“Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. në veprimtarinë e transmetimit të gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 30.08.2023, të depozitojë në ERE Certifikatën e Sigurimit.”*
2. Ky vendim i shtrin efektet duke filluar nga data 01.05.2023.
3. Drejtoria e Gazit Natyror, të njoftojë shoqërinë “ALBGAZ” sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI